

MENDO

SGS KODI I INTEGRITETIT

TË NDERUAR KOLEGË,

Integriteti është në thelbin e SGS. Çelësi i suksesit tonë, si organizatë e si individë, është besimi që ne frymëzojmë te klientët dhe palët e interesuara.


Si udhëheqës në industrinë tonë, ne u përmbahemi standarteve më të larta të sjelljes profesionale. Kodi ynë i Integritetit është shprehje e vlerave që ndajmë në SGS, në bizneset e degët e ndryshme të saj.

Për të arritur objektivat tona, ne synojmë të tërheqim e të kemi punonjës që kanë pasion të punojnë me udhëheqje, drejtësi e ndershmëri. Ne jemi të vetëdijshëm se kemi përgjegjësi ndaj njëri tjetrit e ndaj klientëve tanë për t'iu përmbajtur parimeve tona të integritetit.

Ne jemi mbrojtës të markës e reputacionit të SGS dhe vazhdimisht punojmë për të mbrojtur vlerat që ne ndajmë në treg. Ne e arrijmë këtë synim duke e bërë biznesin tonë me ndershmëri e transparencë.

Si pjesë e këtij angazhimi, ne nxisim një kulturë e hapur ku të ketë shkëmbim idesh dhe informacioni, kërkohen këshilla e ngrihen shqetësime pa frikën e ndonjë pasoje.

Kjo na lejon ne t'u shërbejmë interesave të klientëve tanë në tregjet ku ne zgjedhim të operojmë, duke siguruar mundësi për punonjësit tanë e duke krijuar të ardhura të qëndrueshme financiare për investitorët tanë.



Peter Kalantzis
Kryetar i Bordit



Frankie Ng
Kryeoficer Ekzekutiv

SGS është kompania lider në botë në sektorin e shërbimeve të inspektimit, verifikimit, testimit dhe çertifikimit. U themelua në 1878 nga nevoja e blerësve dhe shitësve për t'u bazuar në inspektime të dërgesave të grurit nga një palë e tretë e pavarur, e ndershme dhe e besueshme. Sot, ndërsa SGS ka shtuar e ka zgjeruar fushat e ekspertizës, ajo vazhdon të përmbushë rolin e një pale të tretë të pavarur e profesionale, në të cilën mund bazohen tregtarët, prodhuesit, konsumatorët dhe qeveritë.

Suksesi i SGS qëndron në besimin që ajo fiton çdo ditë nga klientët, punonjësit, investitorët dhe komunitetet ku bën biznes.

Ky besim është fituar nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të shumë brezave të punonjësve të SGS. SGS është e përqendruar në ruajtjen e këtij besimi nëpërmjet zbatimit efikas të këtij Kodi Integriteti.

ZBATIMI I KODIT

Kodi është i zbatueshëm për të gjithë punonjësit, zyrtarët dhe drejtuesit e SGS e të kompanive e degëve të saj. Të gjitha aspektet e Kodit të cilat nuk janë të lidhura vetëm me punonjësit e SGS, duhet të respektohen gjithashtu edhe prej kontraktorëve, konsulentëve, bashkëpunëtorëve të pavarur, partnerëve në sipërmarrje bashkimesh, agjentëve, nënkontraktorëve dhe çdokujt që vepron në emrin e SGS ose që përfaqëson SGS.

TË KUPTUARIT E KODIT

Është përgjegjësi individuale e çdo punonjësi të SGS të lexojë e kuptojë Kodin, dhe të angazhohet për t'iu përmbajtur parimeve të tij. Punonjësve u kërkohet të marrin pjesë në trajnimin periodik të integritetit të SGS. Punonjësit në role drejtuese duhet të sigurojnë gjithashtu se punonjësit që u raportojnë atyre drejtpërdrejt janë trajnuar siç kërkohet, kanë kuptuar dhe janë në gjendje të veprojnë sipas Kodit.

TË KËRKUARIT E UDHËZIMEVE

SGS është e angazhuar për një kulturë ku çështjet e integritetit dhe etikës profesionale të ngrihen e diskutohen hapur. Për të ndihmuar punonjësit të kuptojnë Kodit e që të marrin vendime të drejta kur përballen me situata të vështira etike, jepen udhëzues dhe mbështetje.

JO PASOJA PËR RAPORTIMET NË MIRËBESIM

Punonjësit janë të nxitur të ngrejnë zërin e të raportojnë çdo shqetësim ose dyshim për shkelje të Kodit. SGS siguron se askush nuk përballlet me ndonjë formë të hakmarrjes ose me pasoja rënduese pse ka kërkuar udhëzime ose raportuar për shkelje të Kodit.

Hakmarrja ndaj një punonjësi që ka raportuar një shkelje në mirëbesim, do të pasohet nga masa disiplinore.

NJË KULTURË E INTEGRITETIT

PARIMET E INTEGRITETIT TË SGS

- **BESIMI:** ky është aset i yndër më i çmuar, themeli i markës dhe reputacionit tonë. Klientët bazohen në integritetin tonë e ky besim duhet të rritet e mbrohet ditë pas dite. Ai mund të rrezikohet në çdo çast.
- **NDERSHMËRI DHE TRANSPARENÇË:** në gjithçka ne bëjmë, duhet të jemi të vërtetë ndaj vetes, klientëve tanë dhe kolegëve.
- Asnjë rrethanë nuk shfajëson gënjeshtat, mashtrimin ose pandershmërinë.
- **PËRGJEGJËSI:** çdo veprim apo neglizhencë e jona ka pasoja. Ne pranojmë pasojat e zgjedhjeve tona dhe nuk fajësojmë të tjerët për veprimet tona.
- **PARIMET:** ne besojmë në veprimin me etikë, me drejtësi e me respekt ndaj të tjerëve. Në vendimet tona udhëhiqemi nga respekti për parimet dhe standartet e sjelljes së mirë, e jo nga zgjedhje arbitrare apo pëlqesa personale.

BËJINI VETES PYETJET E DUHURA

- A dyshoj se një veprim i caktuar mund të jetë i paligjshëm ose jo etik?
- Si do të dukej ky vendim nëse do të dilte në gazeta, ose nëse do të flisja me për këtë me familjen dhe miqtë e mi?
- A nënkuptojnë veprimet që duhet të ndërmerren, se duhet jemi gënjeshtarë e të pavërtetë?
- A mund të rrezikojë veprimi im sigurinë ose shëndetin personal të të tjerëve?
- A mund të rrezikojë veprimi SGS ose reputacionin e saj?
- A ka ky shkëmbim një qëllim biznesi të ligjshëm?

Kur një veprim i propozuar nuk e kalon ndonjërin prej këtyre testeve, ju duhet të kërkoni udhëzime e të rishqyrtoni vendimin tuaj.

JO TOLERANCE PËR SHKELJET

Çdo shkelje e Kodit, sado e lehtë, mund të dëmtojë reputacionin dhe markën e SGS dhe nuk tolerohet. Shkeljet e Kodit do të rezultojnë në masa disiplinore, që shkojnë deri në ndërprerje të kontratës apo dhe ndjekje penale për shkeljet e rënda.

TË KËRKOSH UDHËZIM OSE TË NGRESH SHQETËSIM

Sa herë ka dyshime mbi kuptimin e Kodit ose zbatimin e tij në rrethana të veçanta, punonjësit duhet t'i diskutojnë me drejtuesin ose menaxherin, departamentin e Burimeve Njerëzore ose me departamentin ligjor të SGS. Detajet e kontakteve të burimeve ligjore të SGS mund të gjenden në intranet. Punonjësit mund të diskutojnë edhe me audituesit e brendshëm për çështje që lidhen me këtë Kod.

Nëse për një punonjës nuk është e mundur apo e përshtatshme të adresojë shqetësimin te drejtuesi i tij i linjës, ai mund të kontaktojë gjithnjë edhe Kryeoficerin e Pajtueshmërisë të SGS. Punonjësit që marrin dijeni për një shkelje ose shkelje të dyshuar të Kodit janë të nxitur të kryejnë një raportim te Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS.

Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS mund të kontaktohet nga punonjës të tashëm e të larguar të SGS, nga klientë ose furnitorë, ose palë të treta për çështje të lidhura me Kodin, nëpërmjet çdonjërës prej mënyrave si më poshtë:

- Me postë: SGS SA / në vëmendje të Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS / 1 place des Alpes, P.O. Box 2152, CH – 1211 Geneva 1
- integrityhelpline.sgs.com
- Telefon ose Fax:
 - t +41 (0)22 739 91 00
 - f +41 (0)22 739 98 81 (gjatë orarit të punës së Gjenevës)
- Linja Ndihmëse për Integritetin në SGS: +1 800 461-9330 (numër pa pagesë, funksionon 24 orë, çdo ditë)

Linja Ndihmëse për Integritetin në SGS operohet nga një furnitor i pavarur shërbimesh, i specializuar në trajtimin e shqetësimeve në lidhje me pajtueshmërinë dhe etikën. Në më të shumtën e rasteve, personi që telefonon Linjën Ndihmëse për Integritetin në SGS mund të flasë me një operator e të marrë informacion në gjuhën e vet. Komunikimi që kryhet nëpërmjet Linjës Ndihmëse për Integritetin në SGS trajtohet me fshehtësi dhe i raportohet Kryeoficerit të Pajtueshmërisë të SGS, i cili ruan anonimatin e informatorit, sa herë që kërkohet.

Kur merret kontakt me Kryeoficerin e Pajtueshmërisë të SGS, një menaxher të Burimeve Njerëzore, një auditues të brendshëm ose një jurist të brendshëm në SGS, informacioni që jepet mbahet i fshehtë dhe përdoret vetëm për të dhënë përgjigje ose për të adresuar çështjen e ngritur. Personat që raportojnë janë të nxitur të thonë emrin e tyre dhe kontaktet por, mund të zgjedhin që të mbajnë të fshehtë identitetin e tyre. Në këtë rast, mund të zgjidhet një mjet i duhur komunikimi për t'i lejuar raportuesit marrjen e përgjigjes pa e zbuluar identitetin e saj/tij.

Dyshimet mbi shkelje të Kodit të Integritetit që sillen në vëmendje të Kryeoficerit të Pajtueshmërisë të SGS hetohen me drejtësi. Kur është e përshtatshme, personit që ka bërë ankesën apo raportuar çështjen, i jepet informacion mbi rezultatin e hetimit.

INTEGRITETI I SHËRBIMEVE

Të gjitha shërbimet e SGS duhet të ndërmerren me profesionalitet dhe ndershmëri në përputhje me standartet, metodat dhe politikat e miratuara.

SGS ruan pavarësinë saj të gjykimit dhe nuk i dorëzohet presionit ose nxitjes për të raportuar ndryshe gjetjet ose ndryshuar rezultatet e inspektimeve, çertifikimeve, auditeve dhe testeve të kryera. Të gjitha gjetjet duhet të dokumentohen siç duhet dhe nuk duhet të lëshohen raporte e çertifikata të pavërteta ose ndryshe nga gjetjet.

Të gjitha gjetjet dhe rezultatet duhet të dokumentohen me kujdes dhe nuk duhen bërë ndryshime të paligjshme në to. Gjetjet dhe opinionet e dhëna nga SGS do të mbështeten në informacione pune të sakta e raportime të bëra në përputhje me politikat përkatëse të Grupit SGS.

INTEGRITETI I REGJISTRAVE FINANCIARE

Informacioni i ruajtur në regjistrat financiare të SGS duhet të jetë i vërtetë e i drejtë, në kohën e duhur dhe i saktë. Të gjitha transaksionet duhet të regjistrohen siç duhet e me saktësi dhe të dhënat e regjistruara duhet të shoqërohen nga dokumentacioni i duhur i prodhuar nga palë të mirëbesuara.

Të gjitha regjistrimet duhet të ruhen në përputhje me ligjet në fuqi dhe politikat e Grupit SGS.

KONFLIKTET E INTERESIT

KONFLIKTET E INTERESIT: NË PËRGJITHËSI

Konfliktet e interesit, ose gjasat për konflikte interesi, duhet të shmangen. Punonjësit e SGS duhet të deklarojnë te drejtuesi i linjës (ose te Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS) sapo ata marrin dijeni se për interesa personale të tyre apo të të afërmeve ose miqve të ngushtë, ka gjasa të jenë në konflikt me interesin e SGS.

Një konflikt interesi ndodh kur gjasat për përfitime personale nga ana e një punonjësi, mund të ndikojnë në gjykimin, objektivitetin, pavarësinë dhe besnikërinë e punonjësit ndaj SGS.

E njëjta gjë vlen për të afërmit e miqtë e ngushtë të punonjësit të SGS kanë veprimtari ose interesa që bien ndesh me interesat e SGS.

Konfliktet e interesit mund të lindin në shumë raste. Punonjësit duhet të kërkojnë udhëzime nëse kanë dyshime.

Punonjësit duhet të deklarojnë menjëherë me shkrim të gjitha konfliktet e mundshme të interesit te drejtuesi i tyre dhe të tërhiqen nga procesi i vendimmarrjes për aq kohë sa ata janë të ndikuar nga një konflikt i mundshëm interesi.

TË AFËRMIT: PËRKUFIZIM

Si të afërm të ngushtë të një punonjësi përfshihen: bashkëshorti/ja ose partneri/ja; fëmijët, nipërit e mbesat; prindërit e gjyshërit; vëllai e motra; kunati e kunata; dhëndri e nusja; dhe çdo person që jeton gjithë kohës me punonjësin. Kur duhet të merren parasysh zakone të caktuara vendore, degët e SGS mund të nxjerrin politika vendore për zgjerimin e listës me të afërm të tjerë.

KËRKESA PËR MIRATIM PARAPRAK

Disa konflikte të mundshme të interesit me të cilat përballen punonjësit e SGS mund të zgjidhen me miratim paraprak dhe lejen e duhur nga SGS. Këto përfshijnë:

PËR DREJTUES JASHTË SGS

Për të shërbyer në bordin drejtues të një kompanie jashtë SGS, për të shërbyer në bordin e një shoqate profesioniste ose tregëtie ose marrja e një emërimi politik në nivel vendor apo kombëtar, kërkohet miratim paraprak nga Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS (për anëtarët e Këshillit të Operimeve kërkohet miratim paraprak nga Komiteti i Sjelljes Profesionale).

PUNA JASHTË SGS

Bërja e një pune ose punësimi tjetër jashtë SGS kërkon miratim paraprak me shkrim nga Drejtori Menaxhues i degës dhe nga Menaxheri Rajonal i Burimeve Njerëzore. Megjithatë, nuk lejohen situatat e mëposhtme: (i) puna ose punësimi te një klient i SGS, për të cilin punonjësi përgjatë punësimit në SGS kryen edhe shërbimet e SGS për këtë klient; (ii) puna ose punësimi të një konkurrent i SGS; ose (iii) puna ose punësimi te një kompani që furnizon SGS me mallra e shërbime.

PUNËSIMI I TË AFËRMVE TË NGUSHTË

Punësimi i të afërmeve të ngushtë të një punonjësi aktual në SGS kërkon miratim paraprak me shkrim nga Drejtori Menaxhues i degës dhe Menaxheri Rajonal i Burimeve Njerëzore. Po kështu, punësimi i të afërmeve të anëtarëve të Këshillit të Operimeve, ose të drejtorëve menaxhues të degëve të SGS ose të vartësve të drejtpërdrejtë të tyre, kërkon miratim paraprak me shkrim nga Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS. Në asnjë rrethanë, një punonjësi të SGS nuk i lejohet që të punësojë, mbikqyrë ose të ndikojë në termat dhe kushtet e punësimit të një të afërmi të ngushtë.

NUK LEJOHET

Disa situata të konflikteve të interesit nuk lejohen për punonjësit e SGS. Këto përfshijnë:

VETË-NEGOCIMI

- Ofrimi ose pjesëmarrja personalisht në ndonjë lloj shërbimi profesional ose konsulence për një klient ose klient të mundshëm të SGS.
- Konkurrenca ndaj SGS ose kryerja e punëve për një konkurrent të SGS.
- Marrja e përfitimeve personale për vete apo për një të afërm të ngushtë, nëpërmjet shfrytëzimit të pozicionit në SGS ose qasjes në informacionin e SGS.

INVESTIME PERSONALE TË FURNITORËT, KONKURRENTËT DHE KLIENTËT

- Angazhimi me dije në shërbime të një furnitori ose nënkontraktori të SGS në të cilin punonjësi ose një i afërm i tij ka drejtpërdrejt ose jo aksione të konsiderueshme ose interesa te tjera financiare nuk lejohet, përveçse kur: (i) konflikti i mundshëm është deklaruar me transparencë nga punonjësi te drejtuesi i linjës dhe (ii) punonjësi i prekur nga ky konflikt interesi nuk merr pjesë në procesin e prokurimit.
- Kryerja e investimeve personale te një furnitor, nënkontraktor, konkurrent ose një klient i SGS nuk lejohet, përveçse kur blihen aksione në tituj e bursës ku tregtohet për publikun.

PËRDORIMI I ASETVE DHE BURIMEVE NGA KOMPANIA

RUAJTJA E ASETVE DHE FONDEVE TË KOMPANISË

Punonjësit e SGS kanë për detyrë të ruajnë e të përdorin siç duhet asetet dhe fondet e kompanisë nën kontrollin e tyre. Nuk lejohet të përdoren asetet dhe burimet e kompanisë për asnjë formë të përfitimit personal ose për të kryer punë për të jashtëm.

PËRDORIMI I BURIMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Kompjuterat e kompanisë, sistemet e rrjetit dhe mjetet e komunikimit elektronik duhet të përdoren për qëllime profesionale, në përputhje me politikën e SGS. Përdorimi i email, internetit dhe mënyrave të tjera të komunikimit elektronik mund të monitorohet dhe auditohet nga SGS (nëse lejohet nga ligjet përkatëse mbi privatësinë) kur ka dyshime për abuzim.

PROKURIMI

Punonjësit e SGS të ngarkuar me blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga furnitorët ose që përzgjedhin nënkontraktorë duhet ta bëjnë këtë me qëllimin e vetëm që të sigurojnë vlerën më të mirë tërësore për këto shërbime, me fokusin e duhur për cilësinë dhe reputacionin e furnitorit. Ku është e mundur, duhet të kërkojnë oferta konkurruese para përzgjedhjes së një furnitori apo nënkontraktori. SGS nuk u jep kontrata furnitorave bazuar në pëlqesa personale. Ofrimi i çdo forme të përparësive përfitimeve personale nga një furnitor ose prej një personi që kërkon të ofrojë shërbime ndaj SGS është rreptësisht e ndaluar.

MITA DHE KORRUPSIONI

MITA DHE KORRUPSIONI

SGS nuk angazhohet në mitë ose korrupsion të çdo lloji, në asnjë nga vendet ku ajo operon. Punonjësit ose kushdo që punon në emër të SGS, nuk duhet të ofrojë apo kryejë pagesa për zyrtarët shtetërorë, drejtpërdrejt ose jo, ose t'u ofrojë atyre dhurata ose argëtime me qëllim ndikimin në vendimin e tyre, ose t'i nxisë ata për të mundësuar një përfitim jo të ligjshëm për SGS. E njëjta gjë vlen edhe ndaj zyrtarëve e punonjësve të njësisve private.

Çdo punonjës i SGS që merr ose kërkon mitë duhet ta raportojë menjëherë rastin te drejtuesi i tij/saj i linjës dhe/ose te Kryeoficeri i Pajtushmërisë i SGS.

JO PAGESA PËR BIZNES

SGS nuk paguan ose ofron ndonjë formë të nxitjes së paligjshme për qëllim të pasjes biznes për SGS.

NDËRMJETËSIT DHE KONSULENTËT

SGS nuk angazhon shërbime të palëve të treta për të ofruar mitë, komisione të paligjshme ose pagesa haraçi në emër të saj.

SGS nuk përdor shërbime të ndërmjetësve, agjentëve, konsulentëve, partnerëve, partnerëve në bashkime ose kontraktorëve në rastet kur dyshon se partnerët e tillë mund të kryejnë korrupsion ose praktika tregu të tjera të paligjshme. Asnjë agjent ndërmjetës ose shitës nuk mund të merret pa kaluar nëpër një proces të shqyrtimit të kujdesshëm, që kryhet me qëllim vlerësimitin e përshtatshmërisë së tyre dhe nëse pagesat ndaj ndërmjetësve janë në përshtatje me shërbimet që jepen. Kërkesa për marrjen e një ndërmjetësi duhet të mbështetet nga një anëtar i Këshillit të Operimeve të SGS dhe të autorizohet nga Komiteti i Sjelljes Profesionale të SGS. Ndërmjetësve duhet t'u jepen kopje të këtij Kodi, ta nënshkruajnë e pranojnë se dakordësohen të punojnë sipas parimeve të tij në të gjitha aspektet e marrëdhënies së tyre me SGS. Punonjësit e SGS që menaxhojnë përdorimin e një ndërmjetësi kanë përgjegjësi për monitorimin e rregullt të pajtushmërisë së tyre me Kodin.

PAGESAT LEHTËSUERE

Pagesat lehtësuese janë pagesa të vogla modeste në vlerë, që në ndonjë rast kryhen me qëllim përshpejtimin e shërbimeve nga një zyrtar publik i nivelit të ulët për ndonjë veprim rutine, të cilin SGS ka të drejtë ligjore ta gëzojë. Kërkesat nga zyrtarët për pagesa lehtësuese duhet të përballen me qëndresë të fortë e duhet të pranohen vetëm kur ka gjasa që mospagesa të sjellë dëme për punonjësin ose kur mund të krijojë një rrezik domethënës për biznesin e SGS.

RAPORTIMI DHE PASQYRIMI NË KONTABILITET

Nëse rrallëherë kundrejt rrethanave duhet të kryhet një pagesë lehtësuese, punonjësi që kryen ose autorizon pagesën duhet të raportojë me shkrim arsyen për mosshmangien e pagesës, shumën e paguar, datën dhe marrësin e pagesës. Pagesat lehtësuese duhet të kontabilizohen për qëllime auditi. Në varësi të praktikave dhe legjislacionit vendor, degët e SGS mund të vendosin rregulla më të hollësishme e më të rrepta ose të ndalojnë që punonjësit të kryejnë pagesa te tilla lehtësuese.

JO PASOJA ARMIQËSORE PSE REFUZOHET PAGESA E NJË MITE

Asnjë punonjës i SGS nuk do të ketë pasoja pse refuzon të paguajë një mitë, të angazhohet në praktika korruptimi ose që të kryejë një pagesë lehtësuese.

DONACIONET NË POLITIKË DHE KONTRIBUTET NË BAMIRËSI

JO DHURIME POLITIKE OSE FETARE

SGS i përmbahet rreptësisht politikës së asnjëanësisë në proceset politike të çdo vendi ku ajo operon. SGS nuk kontribuon në asnjë vend me fonde ose burime për ndonjë parti politike, zyrtarë të zgjedhur ose kandidatë për poste publike, dhe nuk mbështet asnjë fushatë politike. SGS nuk mbështet asnjë organizatë fetare.

KONTRIBUTET NË BAMIRËSI

Dhurimet prej SGS në organizatat bamirëse ose investimet e drejtpërdrejta të SGS në programe jofitimprurës në bashkësitë ku ajo operon (ku përfshihen ndihmat në përpjekjet për përballimin e emergjencës prej shkatërrimeve natyrore, fondet për arsim, kujdes shëndetsor, studime kërkimi dhe investime të ngjashme jofitimprurës) kërkojnë miratimin paraprak me shkrim nga Kryeficeri i Operimit i SGS që është përgjegjës për rajonin në fjalë. Kontributet në bamirësi me vlerë mbi CHF 10,000 kërkojnë miratimin paraprak të Komitetit të Sjelljes Profesionale të SGS.

Miratimi për çdo formë të kontributeve në bamirësi nuk do të jepet nëse ato bëhen ose në dukje janë për qëllime të ndikimit të zyrtarëve shtetëror ose palëve të treta për të lejuar përfitime të paligjshme për SGS.

DHURATAT DHE ZBAVITJA

PARIME TË PËRGJITHSHME

Asnjë dhuratë, mikpritje apo zbatimje nuk duhet të ofrohet apo pranohet nëse ato ndikojnë jo siç duhet ose në dukje krijojnë një ndikim të papërshtatshëm në vendimet e biznesit.

Dhuratat, mikpritja dhe zbatimja nuk duhet të tejkalojnë atë çfarë është e zakonshme në një marrëdhënie normale biznesi. Çdo formë e zbatimjes që mund të dëmtojë reputacionin e SGS duhet të shmanget. Rregullat e mëposhtme qartësojnë standartin e pritshëm të sjelljes së punonjësve të SGS.

Degët mund të vendosin politika më të hollësishme e më të rrepta për punonjësit e tyre, duke marrë parasysh rrethanat vendore.

DHURATAT E OFRUARA PUNONJËSVE TË SGS

Punonjësit e SGS nuk duhet asnjëherë të pranojnë:

- Pagesa në kesh, bakshish, kredi ose dhurata të barazvlershme me keshin nga furnitorët ose klientët.
- Çdo dhuratë personale, favor, zbatimje ose mikpritje, kur ato jepen në lidhje me shërbimet që kryhen nga SGS.
- Punonjësit e përfshirë në vendimet e prokurimit ose përzgjedhjes së furnitorëve nuk duhet të pranojnë dhurata personale të ofruara nga furnitorët ose furnitorët e mundshëm. Mikpritja dhe zbatimja e zakonshme, ku përfshihet pjesëmarrja në panairë tregtare dhe evente të ngjashme profesionale të sponsorizuara nga furnitorët, janë subjekt i detyrimit për të raportuar dhe marrë leje.

DETYRIMI PËR RAPORTIM DHE MARRJE LEJE

Punonjësve u kërkohet të raportojnë dhe kërkojnë miratim paraprak nga Drejtori Menaxhues i degës së SGS para se të pranojnë ndonjë dhuratë me vlerë mbi CHF 100. Për dhuratat me vlerë mbi CHF 500 duhet të merret miratim edhe nga Kryeficeri i Pajtuëshmërisë i SGS.

Nëse refuzimi dhe kthimi mbrapsht i dhuratave shkakton fyerje, personi që merr dhuratë duhet të gjejë një mënyrë të duhur për të larguar, për shembull nëpërmjet dhurimit të një bamirësi të zgjedhur.

DHURATAT E OFRUARA NGA SGS PËR LIDHJET E BIZNESIT

Dhuratat personale që SGS ofron te klientët ose lidhjet e biznesit kërkojnë miratimin paraprak të Drejtorit Menaxhues të degës SGS për çdo dhuratë me vlerë mbi CHF 100 and, më tej, për dhurata me vlerë mbi CHF 500, duhet miratimi nga Kryeficeri i Pajtuëshmërisë i SGS.

Ofrimi për të paguar udhëtimin dhe qëndrimin e zyrtarëve shtetëror ose të partnerëve të biznesit të SGS në evente të sponsorizuara nga SGS, ose për qëllim të vizitës në një operim të SGS, kërkon miratim paraprak të dy anëtarëve të Këshillit të Operimeve (në parim një Kryeficer Operimi - COO dhe një Nënpresident Ekzekutiv - EVP). Nëse kosto e të tilla udhëtimeve dhe qëndrimeve tejkalon vlerën e CHF 10,000, kërkohet miratimi nga Kryeficeri i Pajtuëshmërisë i SGS.

KONKURRENCA E NDERSHME

SGS kryen biznesin e saj duke përdorur praktika konkurruese e të ndershme në treg. Ajo nuk angazhohet në asnjë mirëkuptim apo marrëveshje me konkurrentët për ndikim jo të ligjshëm në tregjet ku ajo operon.

Veçanërisht, SGS nuk hyn në diskutime në lidhje me çmimet, termat kontraktuale, ndarjet e tregut, ndarjet e territoreve e të klientëve.

SGS nuk hyn në diskutime me konkurrentët për proceset të konkurrimit në tendera.

SGS nuk i tregton shërbimet e saj nëpërmjet mashtrimit dhe keqinformimit si dhe, nuk denigron apo bën akuza të rreme ndaj konkurrentëve. SGS nuk siguron informacion tw fshehtë mbi konkurrentët duke përdorur mjete të paligjshme dhe jo etike.

Ligjet që rregullojnë konkurrencën janë komplekse dhe ndryshojnë në çdo shtet. Duhet të kërkohen këshilla nga burimet ligjore të SGS.

MARRËDHËNIET E PUNONJËSVE

MOSDISKRIMINIMI

Të gjithë punonjësit e SGS duhet të trajtohen dhe vlerësohen vetëm për aftësitë e tyre të lidhura me punën, kualifikimet, sjelljen dhe arritjet.

SGS i bazon të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës në parimin e shanseve të barabarta, pavarësisht rracës, ngjyrës, gjinisë, besimit fetar, përkatësisë politike, antarësimit në sindikata, kombësisë, orientimit seksual, origjinës shoqërore, moshës ose aftësisë të kufizuara. Diskriminimi i bazuar në këto kritere nuk do të tolerohet.

TALLJA OFENDUESE DHE NGACMIMI SEKSUAL

Është e ndaluar çdo formë e abuzimit, ngacmimit dhe talljes. Nuk tolerohen sjelljet seksuale jo të mirëpritura, kërkesat për favor seksual ose kontakte jo të përshtatshme fizike. Të gjithë punonjësit duhet t'i trajtojnë kolegët e tyre punonjës me respekt.

Punonjësit duhet të jenë të vërtetë e të respektueshëm në çdo kohë që kanë të bëjnë me anëtarët e stafit të tyre, kolegët dhe drejtuesit.

Kjo vlen edhe ndaj klientëve të SGS, furnitorëve, punonjësve dhe drejtuesve të tyre.

NDALIMI I PUNËS SË TË MITURVE DHE PUNËS SË DETYRUAR

SGS nuk punëson fëmijë nën moshën e përfundimit të shkollimit të detyrueshëm, e në asnjë rast nën 16 vjeç. Nëse punësohen të rinj të moshës nga 16 deri 18 vjeç, ata mbrohen nga kryerja e çdo pune që mund të dëmtojë shëndetin, mirëqenien, sigurinë dhe edukimin e tyre.

SGS nuk merr pjesë në asnjë formë të skllavërimit, shitjes ose trafikimit të fëmijëve, mbajtjes peng për borxhe ose robërimit, punës të sforcuar ose me detyrim.

SGS nuk përdor në asnjë rrethanë, ndonjë punë me detyrim me forcë, në kampe ose në burgje.

LIRIA E GRUPIMIT NË SHOQATA

SGS njeh të drejtën e punonjësve të saj të krijojnë dhe bashkohen në sindikata tregu e të negociojnë kolektivisht. Në situatat kur e drejta e lirisë së grupimit në shoqata ose negociimi kolektiv janë të kufizuara me ligj, SGS mundëson mjete paralele për grupimin e lirë e të pavarur dhe negociimin kolektiv. Përfaqësuesve të punonjësve u mundësohet koha dhe mjetet e nevojshme për të kryer funksionet e tyre të përfaqësimit.

PAJTUESHMËRIA NGA FURNITORËT DHE NËNKONTRAKTORËT

SGS nuk përdor furnitorë ose nënkontraktorë që përdorin punën e detyruar ose të fëmijëve, dhe përdor shqyrtimin e hollësishëm të arsyeshëm dhe monitoron se si furnitorët dhe nënkontraktorët pajtohen me këto kërkesa.

AMBIENTI, SHËNDETI DHE SIGURIA

AMBIENTI

SGS përpjehet për pakësimin e ndikimit të veprimtarive të saj në mjedis duke përkrahur përdorimin efikas të burimeve natyrore, pakësimin dhe parandalimin e ndotjes dhe minimizimin e çlirimit të substancave të rrezikshme dhe gazeve serrë.

SHËNDETI DHE SIGURIA

Punonjësve duhet t'u sigurohen ambiente të sigurta pune, kushte dhe pajisje në elementet e duhura në vend për parandalimin e lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale.

Punonjësit e SGS duhet të raportojnë çdo aksident pune ose ndotjeje, siç kërkohet nga politikat e SGS ose ligjet përkatëse. Asnjë punonjës nuk do të ndëshkohet për raportimin e një aksidenti ose të një incidenti ndotjeje.

FSHEHTËSIA E INFORMACIONIT

SGS respekton dhe mbron informacionin e fshehtë që i besohet prej klientëve dhe palëve të treta përgjatë bërjes biznesit dhe merr masat e duhura për parandalimin e nxjerrjes aksidentale të tij.

SGS respekton privatësinë dhe natyrën e fshehtë të informacioneve personale të punonjësve të saj. SGS merr dhe përpunon vetëm të dhëna personale të punonjësve, klientëve dhe partnerëve të biznesit aq sa kërkohet për operimin efikas të biznesit të saj ose për të qenë në pajtueshmëri më kërkesat e ligjit. Asnjë punonjës nuk duhet të kërkojë qasje në të dhënat personale e të fshehta, përveçse për qëllime të ligjshme biznesi.

Punonjësit duhet të ruajnë fshehtësinë e informacionit të SGS dhe të dhënat personale të kolegëve e të mos diskutojnë ndonjë informacion të ndjeshëm në lidhje me arritjet financiare të SGS, investimet, strategjitë, planet dhe klientët. Ky detyrim vijon të mbetet edhe pas përfundimit të punësimit.

PRONËSIA INTELEKTUALE

SGS mbron pronësinë e saj intelektuale dhe respekton pronësinë intelektuale të të tjerëve.

Nëpërmjet punës dhe aftësive të punonjësve të saj për inovacion, SGS prodhon ide të vlefshme, shërbime, procese dhe strategji biznesi. Kjo pronësi intelektuale luan një rol qendror në krijimin e epërsisë konkurruese dhe duhet të ushtrohet kontroll për të mos u zbuluar dhe keqpërdorur.

Pronësia intelektuale e SGS gjendet në shumë forma, siç janë proceset, projektet, metodat, procedurat operacionale, strategjitë tregtare e të marketingut, informacioni mbi klientët, modelet e çmimit dhe kostos. Punonjësit nuk duhet ta shpërndajnë, kopjojnë ose përdorin këtë pronësi intelektuale përveçse për qëllimin e duhur.

Punonjësit duhet të kenë të njëjtin kujdes edhe kur janë të ekspozuar ndaj pronësisë intelektuale të klientit.

SGS nuk dhuron me dashje pronësinë Intelektuale të një pale të tretë. Është i ndaluar përdorimi i një programi software të palicensuar, përdorimi ose riprodhimi i materialeve të mbrojtur nga e drejta e autorit ose shkelja me dashje e një patente të vlefshme.

KOMUNIKIMI ME JASHTË SGS

SGS është një shoqëri që tregton aksione në publik dhe ka detyrim të japë informacion që t'u mundësojë investitorëve të marrin vendime të informuara e në kohën e duhur. SGS u jep aksionerëve dhe investitorëve të saj, mbarë tregut dhe komunitetit një informacion të besueshëm, të saktë, transparent dhe të qartë mbi biznesin dhe veprimtarinë e saj. Komunikimi me aksionerët, investitorët, median dhe publikun, në lidhjen me SGS dhe arritjet e saj të biznesit dhe ato financiare, mund të kryhet vetëm prej personave të autorizuar.

Asnjë punonjës nuk duhet të flasë në emër të SGS, të diskutojë ose shpërndajë informacione mbi SGS me median, analistët financiar, investitorë aktualë ose të mundshëm, ose të bëjë deklarata publike në emër të SGS përveçse kur është autorizuar shprehimisht për të bërë një gjë të tillë.

Opinionet personale, në lidhje me besimin fetar dhe politikën, ose çdo lloj tw shprehuri pwr tema tw ndjeshme nuk duhen dhënë me anë të letrave me logo të SGS, email ose çfarëdolloj mënyre tjetër ku opinione të tilla mund shihen si të lëshuara nga SGS.

Kur merret pjesë në forumet e diskutimeve online dhe në mediat sociale, punonjësit e SGS duhet të veprojnë në pajtueshmëri më Kodin e Integritetit dhe Politikën e SGS për Mediat Sociale.

ABUZIMI ME INFORMACIONE TË BRENDSHME

Punonjësit nuk duhet të ndjekin investime personale ose raste për të bërë biznes duke përdorur informacione të brendshme mbi SGS, klientët ose furnitorët e saj.

Është e ndaluar që punonjësit të tregtojnë aksione të SGS, opsione dhe tituj të therë të lëshuar nga SGS ndërkohë që zotërojnë informacione të brendshme, që po të zbulohen, mund të sjellin ndikim në çmimin e aksioneve të SGS. Një informacion nuk është publik kur nuk kështë dhënë zyrtarisht nga SGS në përputhje me rregullat e tregut të aksioneve.

Informacioni i brendshëm tipik përfshin rezultatet financiare, propozime të planeve strategjike për bashkime dhe blerje shoqërisht, si dhe ndryshime të planifikuara në drejtimin e lartë, jo të bëra publike. Para çdo veprimi që mund të jetë në njërin nga këto kategori, duhet të kërkohet këshillim nga burimet legjore të SGS.

Përgjatë bërjes biznesi, ndonjëherë SGS mund të ketë informacion të rëndësishëm të brendshëm mbi klientët ose palët e treta. Punonjësve u ndalohet të tregtojnë aksione të klientëve ose palëve të treta ndërsa zotërojnë informacione të tilla të fshehta.

Është e ndaluar të kalohen informacione, ose të jepen këshilla për palët e treta ose të afërmit duke u bazuar në dijeninë mbi informacionin e brendshëm të marrë përgjatë punësimit në SGS.

VEPRIMI NË PAJTUESHMËRI ME LIGJET

SGS vepron në pajtueshmëri me ligjet në fuqi në çdo vend ku ajo kryen biznes. Legjislacioni që mbulon aspekte të ndryshme të veprimtarive të SGS mund të jetë kompleks. Punonjësit duhet të dinë rregullat që zbatohen për SGS dhe ata si individë. Për çdo dyshim, duhet të kërkohet këshillim nga burimet ligjore të SGS. Padituria mbi ligjin nuk është shfajësim.

Kur ky Kod ose politikat e SGS vendosin standarte më të rrepta se ato të vendosura nga ligji, punonjësit duhet të veprojnë në pajtueshmëri me standartin më të rreptë. Punonjësit duhet të kërkojnë udhëzime kur kanë dyshime se si mund të zgjidhet një kundërvënie ndërmjet këtij Kodi dhe ligjeve në fuqi.

Përgjatë kryerjes së biznesit të SGS, punonjësit mund të kontaktohen nga agjensitë e ligjit ose zyrtarë shtetëror në lidhje me hetime që përfshijnë SGS. Në rastet kur merren kërkesa të pazakonta për informacion dhe dokumentacion, punonjësit duhet të kërkojnë këshilla nga burimet ligjore të SGS. Në asnjë rrethanë nuk duhet që ndokush që vepron në emër të SGS, të tentojë të keqinformojë, fshehtë prova, shkatërrojë dokumenta ose përndryshe të pengojë çdo hetim të ligjshëm.

ZBATIMI

Kodi i Integritetit është miratuar nga Këshilli i Operimeve dhe nga Bordi Drejtues i SGS. Komiteti i Sjelljes Profesionale dhe Bordi Drejtues marrin raportime të rregullta mbi shkeljet dhe mbikqyrin zbatimin e tij.

Kodi hyn në fuqi prej Shkurt 2012 dhe zëvendëson versionin e mëparshëm të vitit 2004.

Degët e SGS janë të autorizuara të adoptojnë politika më të detajuara e më të rrepta mbi aspektet që preken nga ky Kod, me miratim paraprak të me shkrim nga Kryeoficeri i Pajtueshmërisë i SGS.

INFORMACION KONTAKTI

COMPLIANCE CONTACT

1 place des Alpes

P.O. Box 2152

CH – 1211 Geneva 1

t +41 (0)22 739 91 00

f +41 (0)22 739 98 81

integrityhelpline.sgs.com

www.sgs.com

Një falenderim i veçantë u shkon të gjithë punonjësve dhe pjesëmarrësve për kontributin konstruktiv në Kodin tonë të Integritetit.

WWW.SGS.COM

WHEN YOU NEED TO BE SURE

